



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2022:206539

Datë: 21.12.2023

Numri i dokumentit: 05108278

C.nr.739/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Bajram Cacaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.H. nga Komuna e Deçanit, të cilin me autorizim e përfaqëson Sh.H. avokate në Deçan, kundër të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Deçan, në çështjen juridike kompensim mbi bazën e përqindjes së inflacionit, me vlerë të kontestit 708,95 €, jashtë seancës, më datë 21.12.2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- Për shkak të padëgjueshmërisë/mosbindjes –

APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit M.H. dhe DETYROHET e paditura Komuna e Deçanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit t’ia paguaj në emër të pagesës shtesë - përqindjes së inflacionit shumë prej 708,95 euro, shumë kjo e cila i referohet periudhave si në vijim:

- për periudhën janar-dhjetor 2021 shumë prej 171,76 euro;
- për periudhën janar-nëntor 2022 shume prej 537,19 euro,

të gjitha me kamatë ligjore prej 8% nga data 06.10.2022 (data e paraqitjes se padisë) deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 124.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarës të tij në padinë e parashtruar në gjykatë me datë 06.10.2022, si dhe parashtrësën për precizimin e padisë të datës 15.12.2023, ndër të tjera ka theksuar se paditësi

është mësimdhënëse në Shkollën Filllore “Sylë Alaj”, në fshatin Drenoc, Komuna e Deçanit, me kontratë të rregullt të punës ku vazhdon të punoj edhe tani e tutje, thekson se kërkesën e padisë e bazon në obligimet që ka punëdhënësi ndaj paditëses që të paguhet mbi bazën e shkallës së inflacionit, të dhëna këto që merren zyrtarisht nga Enti i Statistikave të Kosovës dhe kjo përqindje të futet në pagë, bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, andaj ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të përqindjes së inflacionit për vitet 2021 dhe 2022 t’i paguaj paditësit shumën e përgjithshme prej 708,95 euro, me kamat ligjore nga data e parashtrimit të padisë, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, pas shqyrtimit paraprak të padisë, ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi, C.nr.725/22 të datës 01.11.2023, me të cilin e ka detyruar të paditurën, që të përgjigjet në padi, të cilin e paditura e ka pranuar me datë 02.11.2023, duke e njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënien e përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do të i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, përkatësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes.

E paditura pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale, si dhe parashtrësën për precizimin e padisë, në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mos bindjes, ka gjetur se në rastin konkret, plotësohen të gjitha kushtet ligjore, për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë, nga neni 150 par. 1, pikat a), b) dhe c) të LPK, e cila dispozitë në mënyrë shprehimore parasheh se: *“Nëse të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështet kërkesëpadia, nuk janë në kundërshtim me provat të cilat i ka propozuar vet paditësi, apo me faktet e ditura botërisht”*.

Gjykata nga provat të cilat i janë bashkëngjitur padisë dhe atë: kontrata e punës e lidhur në mes paditësit dhe të paditurës më datë 18.09.2017, lista e pagave për vitin 2021 (periudha 01.02.2021-28.02.2021) dhe lista e pagave për vitin 2022 (periudha 01.12.2022-31.12.2022), gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka punuar si mësimdhënëse në Shkollën Filllore “Sylë Alaj”, në fshatin Drenoc, Komuna e Deçanit, pra për këtë periudhë ka qenë i punësuar tek e paditura, po ashtu ka vërtetuar se paga bazë për vitet 2021-2022, për paditësin ka qenë 421 euro. Po ashtu, gjykata bazuar në Indeks të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2021 ka qenë 3.4%, ndërsa për vitin 2022 ka qenë 11.6%.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021 e cila ka qenë në fuqi deri me datë 21.11.2022, ku në nenin 35 par.10 ka përcaktuar se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së*

*Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që një dispozitë e tillë është e karakterit imperativ dhe si e tillë do të duhej që shkalla e inflacionit të llogaritet në pagë, marrë parasysh që nga lista e pagave që gjendet në shkresat e lëndës, nuk rezulton që një pagesë e tillë është kryer nga e paditura.*

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke pasur parasysh të dhënat e nxjerra nga Enti i Statistikave të Kosovës sa i përket shkallës mesatare vjetore të inflacionit, sipas përlllogaritjes si në vijim:

- Për periudhën janar-dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, andaj duke e llogaritur pagën bazë të paditësit e cila në vitin 2021 ka qenë 421 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 12 mujore në total të jetë 171,76 euro, apo 14,31 euro për muaj ( $421 \cdot 3,4\% \cdot 12 = 171,76$ ) dhe

- Për periudhën janar-nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, andaj duke e llogaritur pagën bazë të paditësit e cila në vitin 2022 ka qenë 421, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 11 mujore në total të jetë 537,19 euro, apo 48,83 euro për muaj ( $421 \cdot 11,6\% \cdot 11 = 537,19$ ).

Edhe pse përlllogaritja e përqindjes së inflacionit duhet të bëhet sipas shtimit dinarik ndër vite, gjykata në rastin konkret vendosi si në dispozitiv brenda kufijve të kërkesës së palës konform nenit 2.1 të LPK i cili përcakton se: *“Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”.*

Andaj, gjykata vlerëson se nga provat e lartcekura del baza dhe lartësia e kërkesëpadisë, andaj në kuptim të nenit 150 i LPK-së, e në lidhje me dispozitat nga neni 245 paragrafi 1 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), ku përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”,* erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paraqitur nga ana e paditësit është e bazuar dhe në këtë rast e njëjta u aprovua në tërësi si e themeltë, duke obliguar të paditurën në pagimin e detyrimit sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u mor sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK, me ç’rast paditësit iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 124,00 €. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20,00 €, si dhe për përpilimin e padisë shuma prej 104,00 €.

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 150 par.1 të LPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË**

Dega në Deçan

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.739/22, më 21.12.2023

Gjyqtar

---

Bajram Cacaj

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.

Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplarë të mjaftueshëm për palët dhe gjykatën.